

## KONFLIKTI NACIONIZËM – NACIONALIZËM NË GJUHË DHE KONSULTA E PRISHTINËS

(Prishtinë, 22 prill 2008)

*Konsulta gjuhësore e Prishtinës shënon një ngjarje kulmore në planifikimin gjuhësor të shqipës, me një peshë më të madhe se vetë Kongresi i Drejtshkrimit, i cili nuk bëri tjetër veçse sanksionoi vendimin e marrë në Prishtinë.*

*Akti i dijetarëve kosovarë është vlerësuar përgjithësisht si një veprim i lartë patriotik, por nuk është bërë ndonjë përpjekje serioze për të shpjeguar faktorin që çoi në atë vendim. Në kumtimin tonë do të ndalemi pikërisht në këtë faktor, i cili shkaktoi një reaksion zinxhir që nisi në Prishtinë dhe përfundoi në Tiranë. Ky është faktori që në sociolinguistikë quhet konflikti midis funksioneve nacioniste dhe funksioneve nacionaliste të gjuhës në një bashkësi. Një konflikt i tillë midis nevojave nacioniste (që i përmbushte gegërishtja) dhe nevojave nacionaliste (funksioni identifikues i gjuhës) lindi në Kosovë në periudhën që i parapriu Konsultës së Prishtinës. Këtë konflikt Konsulta e zgjidhi në të mirë të funksionit nacionalist. E udhëhequr nga motoja “një komb – një gjuhë”, ajo shpalli në “Konkluzat” e saj se njihje “njëzëri si gjuhë të vetën letrare gjuhën letrare të vendit ëmë”.*

Në përballjen me dy ngjarjet kulturore me rëndësi kombëtare të fundit të shek. XX – me Konsultën e Prishtinës dhe me Kongresin e Prishtinës – shumica e studiuesve që janë marrë me to, kanë mbivlerësuar Kongresin e Drejtshkrimit. Por sa është i mbështetur ky mendim dhe a mund të ndahen këto dy ngjarje nga njëra-tjetra? Kjo do të jetë njëra nga çështjet që do të bëjmë objekt të këtij shkrimi; në pjesën tjetër të tij do të ndalemi në një nga faktorët që çuan në vendimin e Konsultës për të njohur “njëzëri si gjuhë të vetën letrare gjuhën letrare të vendit ëmë”.

Teoria e planifikimit gjuhësor, në përpjekjet për të karakterizuar nga pikëpamja tipologjike atë që njihet si “dukuria e kongresit të parë”, ka përpunuar disa kriterë, të cilat vlejné jo vetëm për të përcaktuar tubimin gjuhësor që përmbush kushtet për të qenë “kongresi i parë” gjuhësor i një gjuhe, por edhe për të vlerësuar se cilave tubime mund t’u njihet statusi i kongresit. Sipas kësaj teorie, një tubim gjuhësor duhet parë nga pikëpamja e organizatorëve dhe e pjesëmarrësve në to; e rrethit të çështjeve që diskutohen në të; e kundërshtarëve me mospjesëmarrje ose pikëpamjet e tyre; e rezolutave dhe e vendimeve të tyre; e shkallës së suksesit në zbatimin e këtyre vendimeve dhe, së fundi, e “shkallës në të cilën ato kujtohen në vitet që pasojné dhe bëhen pjesë e folklorit dhe e mitologjisë së bashkësive gjuhësore”<sup>1</sup>

Le të shohim se cilët prej këtyre kriterëve përmbush Konsulta e Prishtinës, duke filluar me kushtin e parë: organizatorët dhe pjesëmarrësit në të. Sikurse është vënë në dukje nga R. Ismajli, Konsulta gjuhësore e Prishtinës “ishte tubimi i parë ndër shqiptarët e ish-Jugosllavisë që po mbahej vetëm nën përkujdesjen e institucioneve shkencore-kulturore”. Organet e pushtetit nuk ishin të përziera drejtpërsëdrejti në organizimin e konsultës, as si organizues, as si sponsorizues të saj, as përmes pjesëmarrjes së “përfaqësuesve të vet të deleguar në trupat e punës të konsultës”<sup>2</sup> Politika ishte e dyzuar: më njërën anë ishin politikanët që “pajtoheshin plotësisht” me qëllimet dhe vendimin e Konsultës; më anë tjetër, politikanë në shërbim të politikave asimiluese të Federatës Jugosllave. Për sa i përket shkallës së përfaqësimit në rrafsh kombëtar, pasi diskutohej një çështje kombëtare, sipas I. Ajetit, pjesëmarrësit e vetëm në të ishin përfaqësues të “arsimit, të kulturës, të shkencës e të publicistikës të shqiptarëve në

1 J. A. Fishman, *Introduction: Exploring an overlooked sociolinguistic phenomenon (The First Congress for Language X)*, në J. A. Fishman (ed.) “The Earliest Stage of Language Planning (The First Congress Phenomenon)”, Mouton de Gruyter, Berlin . New York, 1993, p. 6.

2 R. Ismajli, “Në gjuhë” dhe “për gjuhë”, Pejë, 1998, f. 184.

Jugosllavi”<sup>3</sup>. Në të munguan përfaqësues nga trangu amë, ndryshe nga ç’ndodhi në Kongresin e Manastirit, që është kongresi i parë gjuhësor i shqipes, dhe sidomos në Kongresin e Drejtshkrimit, ku pati përfaqësues edhe prej diasporës.

Sa i përket rrethit të çështjeve të trajtuara në të, edhe pse materialet e Konsultës nuk janë botuar, temë themelore e saj ishte çështja e gjuhës letrare, e shprehur në devizën “një komb – një gjuhë letrare”, të formuluar prej akademikut Ali Hadri. Pra, ndryshe nga Kongresi i Drejtshkrimit, ku u rrahën gjerësisht problemet e gjuhës letrare dhe të kodit të saj drejtshkrimor, në Konsultë çështjet teknike lidhur me kodin drejtshkrimor u prekën pak, duke pranuar *in toto* projektin e drejtshkrimit të 1967-ës. Shkaku i tematikës më të ngushtë, sipas Ismajlit, shpjegohet me atë se “te shqiptarët e ish-Jugosllavisë planifikimi i funksioneve dhe i statusit të gjuhës letrare ishte çështje jetike, ndërsa planifikimi i kodit, edhe kur specialistët mund të kishin vërejtje, shpallej çështje më pak e rëndësishme”<sup>4</sup>. Megjithatë, edhe pse disi e ngushtë, kjo tematikë ishte e denjë për një kongres gjuhësor.

Është e natyrshme që në tubime të tilla të ketë diskutime, mëdyshje dhe mendime ndryshe. Por, sikurse e vumë në dukje më sipër, me përjashtime të pakta që nuk ia vlen të përmenden, pjesëmarrësit dhe publiku i gjerë i pranuan njëzëri vendimet e Rezolutës. Lidhur me kundërshtimet e mundshme ndaj “importimit në Jugosllavi të një norme të krijuar në Tiranë”, Xhenet Bajroni, studiuesja më kompetente e procesit të standardizimit të shqipes, vëren se gegët janë “shumë besnikë ndaj dialektit të vet”, prandaj “ka gjasa që disa syresh në Jugosllavi të kenë qenë kundër importimit të shqipes standarde në bashkësinë e tyre”. Edhe pse nuk gjen të tillë që të jenë shqiptuar publikisht kundër me shkrime apo deklarata, ajo thotë se “për shkallën e kundërshtimit në Jugosllavi mund të bindesh kryesisht nga sulmet e botuara të përkrahësve të shqipes standarde ndaj kundërshtarëve të standardit që nuk përmenden me emër”<sup>5</sup>. Për këtë i referohet shkrimit “Shkrimtari dhe gjuha letrare” të R. Qoses, të mbajtur si kumtesë në Kongresin e Drejtshkrimit, ku autori vërtet përmend për “refuzimin e disa shkrimtarëve të Kosovës që t’i përmbahen marrëveshjes së arritur në Konsultën e drejtshkrimit”, por edhe ky pa përmendur emra<sup>6</sup>. Kërkimin e kundërshtarëve të gjuhës standarde në trojet shqiptare të Federatës e ka vijuar rreth 20 vjet më vonë nga Xhenet Bajroni studiuesi R. Ismajli. I nisur nga një artikull për Konsultën i botuar gjatë muajit prill në gazetën “Rilindja”, ku me një “ton gati polemizues” shpjegohej zgjedhja e bërë, ai arrin në përfundimin se “ky koment sikur donte të tregonte se në ç’pikë do të kenë qenë dilemat dhe vërejtjet e atyre që eventualisht mund të kenë pasur rezerva”<sup>7</sup>. Megjithatë, dhe Ismajli nuk arrin të përmendë me emër ndonjë të tillë dhe detyrohet të pohojë që “për ndërhyrje eventuale mund të ngremë vetëm pandehma”<sup>8</sup>. Mungesa e qëndrimeve kundër shpjegohet prej tij me atë që mbështetja prej studentëve dhe publikut të pranishëm në sallë “kishte bërë që ndonjë nga pjesëmarrësit, që mund të kishte rezerva ose dilema, të tërhiqej, ose të mos i shfaqte ato”. Madje, duke folur për ndrojtjen e Ajetit në parashtrimin e tezës se “variantën e gjuhës së shkrimit ta shpiem në përdorimin me tri a katër pika dalluese nga variantja toske e gjuhës sonë letrare”, Ismajli pranon se “mirëkuptimi e kërkesa që shtronte opinionin në konsultë ia shtonin atij (I. Ajetit–R. M.) bindjen për nevojën e njësimin”<sup>9</sup>. Pra, përderisa mëdyshjet dhe mospajtimet nuk janë nyjëtuar në shkrime a intervista, kjo do të thotë se këtyre kundërshtimeve u ka munguar forca e argumentit. Pikërisht, mungesa e kontestimeve është karakteristikë e kongreseve gjuhësore dhe, nga kjo pikëpamje, Konsulta e Prishtinës ngjan me

3 I. Ajeti, *Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë*, në "Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe", I, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Tiranë, 1973, f. 278.

4 R. Ismajli, *"Në gjuhë" dhe "për gjuhë"*, f. 189.

5 J. Byron, *Language planning in Albania...*, p. 41.

6 R. Qosja, *Shkrimtarët dhe gjuha letrare*, në "Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, 20–25 nëntor 1972", vëll. I, f. 339.

7 R. Ismajli, *"Në gjuhë" dhe "për gjuhë"*, f. 184.

8 Po aty, f. 185.

9 Po aty, f. 178.

një kongres gjuhësor, madje duke ia kaluar Kongresit të Drejtshkrimit, ndaj të cilit ka pasur mjaft kontestime.

Edhe vendimi për përdorimin në trojet shqiptare të ish-Jugosllavisë të “gjuhës letrare të vendit ëmë” qe me pasoja që mund t’i atribuohen vetëm një Kongresi. Por la të shohim më konkretisht se cilat qenë vendimet e Konsultës dhe cila qe shkalla e zbatimit të tyre në trojet shqiptare të Federatës.

Ndër vendimet e “Konkluzave” të tërheqin vëmendjen pikat 4, 5 dhe 9.

“4. Projekti i Ortografisë që u zu ngojë, e që shërbeu si bazë diskutimi në këtë Konsultë, porsa të aprovohet dhe të marrë formë zyrtare në Republikën Popullore të Shqipërisë, do të zbatohet.

5. Në ndërkohë, dmth. derisa të aprovohet, Projekti ekzistues është një bazë e shëndoshë dhe mund të zbatohet dhe të konsiderohet ortografi shqipe.

9. Instituti e Katedra autorizohen t’u rekomandojnë institucioneve arsimore e enteve arsimore e pedagogjike, gazetare e botuese, shkencore e kulturave që të krijojnë mundësitë e zbatimit sa më të shpejtë të konkluzave të Konsultës.”<sup>10</sup>

Nga këto pika merren vesh lehtë pasojat largvajtëse të vendimeve të Konsultës. Duke pranuar “Projektin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe” si një bazë të shëndoshë që mund të konsiderohej dhe të zbatohet si ortografi shqipe e njësuar, Konsulta i hapi dritën e gjelbër njësimi të ortografisë. Nga ana tjetër, autorizimi i Instituti dhe i katedrës së gjuhës shqipe për t’u rekomanduar institucioneve arsimore, shkencore, kulturore dhe shtypit zbatimin e vendimit të Konsultës, do të thotë që në Kosovë zbatimi i drejtshkrimit të njësuar të fillonte 5 vjet më parë se në Shqipërinë politike, ku “Projekti i drejtshkrimit” nuk kishte marrë ende fuqi zyrtare. Aty mbetej në fuqi ortografia e vitit 1956 dhe zbatoheshin dy ortografi: e gegërishtes dhe e toskërishtes. Pasojat e zbatimit të vendimeve të Konsultës qenë edhe më largvajtëse: Me heqjen dorë nga Ortografia gege e 1964-ës dhe pranimin e “Projektit të drejtshkrimit”, që mbështetej në toskërishten, ndryshonte automatikisht statusi i variantit letrar tosk dhe i gegërishtes. Ndërsa gjer atëherë toskërishtja dhe gegërishtja gëzonin një status të njëjtë, duke shërbyer e para si gjuhë zyrtare e shtetit shqiptar, kurse e dyta si gjuhë zyrtare rajonale në Kosovë, me vendimet e Konsultës toskërishtja në trojet shqiptare të Federatës u ngrit në një shkallë më të lartë, duke fituar *de facto* statusin e gjuhës standarde, ndërsa gegërishtja e humbi statusin e gjuhës zyrtare, duke bjerrë edhe prestigjin e saj.

Por efektin më të madh Konsulta e Prishtinës e pati mbi vetë vendin amë, ku deri më 1968 askush nuk e kishte vuar mendjen për këto gjëra. Toskërishtja dhe gegërishtja e shkruar përdorehin aty paralelisht në shumë fusha, përfshirë edhe shtypin e specializuar gjuhësor, ndonëse jo me status të njëjtë, pasi toskërishtja gëzonte statusin e gjuhës zyrtare. Si të thuash, në Shqipërinë politike ishin të kënaqur me gjendjen ekzistuese. Edhe gjuhëtarët nuk ndienin ndonjë ngut. Sociolinguistika dhe teoria e planifikimit gjuhësor, që ishin në fillimet e veta edhe në Perëndim, në Shqipëri asokohe nuk njiheshin fare. Ndër gjuhëtarët shqiptarë të kohës mbizotëronte ideja e konvergencës spontane të dialekteve në një gjuhë letrare të njësuar, e nyjëtuar më qartë nga A. Xhuvani. Lidhur me prirjen e afrimit të ngadalshëm të të dy dialekteve të shqipes, që i shihte si “dy qe në një parmendë”, ai theksonte më 1932 se gjuha e shkrimit “asht tue marrë natyrisht e pakuptueshëm, një rrugë bashkimi të të dy dialekteve, që, tue influencue njeni-tjetrin, në një kohë (doemos të largët e të pamundun me u caktue sot) do të bien në një konvergencë të dëshirueshme”<sup>11</sup>. Kjo i dukej atij si rruga “ma e natyrshme dhe ma e dëshirueshme”.

Përveç bindjes se gjuha letrare do të krijohej në mënyrë spontane dhe në një të ardhme shumë të largët, në indiferencën e gjuhëtarëve në Shqipërinë politike ndikonin edhe faktorë të tjerë. Së pari, kjo pjesë kishte shtetin e vet kombëtar dhe nuk ndiente kurrfarë rrezikimi të identitetit

<sup>10</sup> Konkluzat e Konsultës..., art. i cit.

<sup>11</sup> A. Xhuvani, *Gjuha e letërsia shqipe*, Vepra, II, f. 415.

sikundër pjesa tjetër e kombit e mbetur në Jugosllavi. Kësaj i duhet shtuar edhe rrethana tjetër që, për shkak të dallimeve ideologjike me Beogradin, por dhe të dogmës së “internacionalizmit proletar”, problemi kombëtar i pazgjidhur dhe popullsia shqiptare që jetonte jashtë kufijve të shtetit shqiptar, pothuajse ishin harruar. Këto ishin arsyet se përse Tirana u gjend e “befasuar me vendimet e Konsultës së Prishtinës, madje e papërgatitur për të reaguar në mënyrë përkatëse”<sup>12</sup>, sikurse vëren, me të drejtë, R. Ismajli.

Pika 8 e konkluzave autorizonte “Institutin Albanologjik dhe katedrën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe, si organizues të kësaj konsulte, që ta njoftojnë Universitetin Shtetëror të Tiranës me konkluzat e tubimit dhe me vërejtjet e bëra rreth projektit të ortografisë”<sup>13</sup>. Pikërisht këtu nis reaksioni zinxhir që shpuri në Kongresin e Drejtshkrimit. A. Kostallari, i cili si drejtues i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, ka qenë në dijeni të të gjitha zhvillimeve gjuhësore në të dy anët e kufirit, nuk arriti ta regjistronte vargun e ngjarjeve që çuan në Kongresin e Drejtshkrimit. Por mund të themi me siguri se qenë pikërisht kambanat që ranë në Prishtinë ato që zgjuan nga gjumi drejtuesit e gjuhësisë dhe, ndoshta, edhe politikën, në Shqipëri, e cila e kishte për detyrë ta përkrahte dhe ta mbështeste financiarisht këtë nismë. Këtë e ka vënë në dukje vetëm pak vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit Xh. Bajroni, e cila thotë se “zgjerimi i bazës (së shqipes standarde–R. M.) u iniciua nga shqiptarët Jugosllavisë”<sup>14</sup>, duke i nxitur planifikuesit e gjuhës në Shqipërinë politike që planifikimin gjuhësor ta shihnin jo në suazat e ngushta të shtetit, po në suazat e gjithë kombit.

Është e vërtetë se, për sa i përket shkallës dhe suksesit të zbatimit të vendimeve, Konsulta nuk mund ta kishte suksesin që patën vendimet e Kongresit të Drejtshkrimit, të cilat u zbatuan në shkallë kombëtare, këndej dhe andej kufijve. Por merita e Konsultës është se vuri në lëvizje Tiranën, aq sa mund të pohojmë me siguri të plotë se, pa të, nuk do të kishte pasur as Kongres Drejtshkrimi dhe shqiptarët nuk do të kishin as sot e tërë ditën një gjuhë standarde. Të mos harrojmë se fqinji ynë jugor, Greqia, me një traditë letrare shumë më të lashtë se jona, u bë me gjuhë standarde vetëm më 1976, gati një shekull e gjysmë pas shpalljes së pavarësisë. Prandaj Konsultën e Prishtinës dhe Kongresin e Drejtshkrimit ne nuk i shohim të veçuara, po si dy ngjarje komplementare, si dy faza të lidhura ngushtë të procesit të standardizimit të shqipes, i cili nuk do të kishte përfunduar me sukses duke u mbështetur vetëm në njërin prej tyre.

Së fundi, lidhur me kriterin e *shkallës në të cilën ngjarje të tilla “kujtohen në vitet që pasojnë dhe bëhen pjesë e folklorit dhe e mitologjisë së bashkësive gjuhësore”*, mund të themi se pjesa e kombit jashtë kufijve politikë ka qenë plotësisht e vetëdijshme për rëndësinë dhe rolin e Konsultës së Prishtinës. Një provë e kësaj është edhe konferenca përkujtimore e organizuar nga Instituti Albanologjik në përvjetorin e 40-të të Konsultës.

Rrjedhat e planifikimit gjuhësor në Prishtinë, veçanërisht zhvillimet e vitit 1968 janë bërë objekt studimi prej R. Ismajlit në mjaft nga punimet e tij, në të cilat sillen mjaft fakte dhe bëhen analiza të hollësishme. Por, për hir të së vërtetës, duhet thënë se, përveç analizave koherente, në këto punime gjejmë edhe hamendësime që nuk i qëndrojnë së vërtetës. Kështu, kur flet për zgjedhjet e ndryshme të gjuhës zyrtare në Shqipërinë politike dhe në trojet jashtë kufijve, ai thotë: “Nga ana tjetër, në Shqipëri kjo nuk u la pa u shfrytëzuar nga ato forca shoqërore që donin të impononin bazën e toskërishtes: izolimi nga Kosova ua bënte atyre (udhëheqësve politikë) të mundshme të impononin zgjidhje vetëm për suazat e Republikës, me bindjen se më vonë shqiptarët e mbetur jashtë shtetit shqiptar, për këtë arsye me siguri edhe të mbetur prapa, do të pranonin zgjidhjen që u imponohej. Mosshkëputja e lidhjeve e cekur më sipër e bënte më reale këtë shpresë” (sic!). Apo që: “Rënia e Rankoviçit më 1966, entuziazmi çlirimtar i krijuar në atë atmosferë, e rritën nevojën e afrimit në shkallën që të mos mendohej fare për pengesat apo për problemet eventuale që mund të dilnin në atë rrugë

12 R. Ismajli, *"Në gjuhë" dhe "për gjuhë"*, vep. e cit. f. 201.

13 Po aty, f. 316.

14 J. Byron, *Language Planning in Albania and in Albanian-Speaking Yugoslavia*, Word, vol. 30. nr. 1-2, April-August, p. 31.

brenda “nesh”. Konsulta gjuhësore e Prishtinës ishte rrjedhojë krejtësisht e natyrshme e kësaj klime.”<sup>15</sup>

Kjo do të thotë as më pak a as më shumë, po që vendimi i Konsultës së Prishtinës për përdorimin e “gjuhës së shtetit ëmë” që një zgjedhje e detyruar, shtegu i vetëm i shpëtimit për shqiptarët e trojeve jashtë kufijve politikë. Faktet mund t’i interpretojmë si të duam, por interpretimi ynë nuk e ndryshon aspak vërtetësinë e tyre. Hamendësime të tilla, që bien era lokalizëm dhe shpërshije për trungun amë, nuk mbështeten nga faktet reale dhe, si të tilla, nuk i bëjnë aspak nder një njeriu të kultivuar, sidomos një gjuhëtar me ndihmesa në studimin e planifikimit gjuhësor të shqipes.

Nga të huajt, rolin e Konsultës së Prishtinës e ka analizuar me kompetencë dhe objektivitet Xhenet Bajroni në artikullin “Language Planning in Albania and in Albanian-Speaking Yugoslavia” (1979), në të cilin gjejmë një varg pohimesh të rëndësishme për situatën gjuhësore të Shqipërisë politike dhe të trojeve shqiptare në Jugosllavi. Lidhur me rolin e Konsultës në procesin e standardizimit të shqipes, kjo autore thotë: “Pjesëmarrja e shqiptarëve të Jugosllavisë në Kongres solli pranimin për herë të parë zyrtar nga Tirana se në fushën e planifikimit të gjuhës qeveria shqiptare nuk do të ndiqte më një rrugë të veçantë zhvillimi. Por kjo hapje rrugës u iniciua nga shqiptarët e Jugosllavisë”<sup>16</sup>. Sipas kësaj autoreje, që i ka ndjekur in situ zhvillimet, “nuk ka dëshmi që të provojë se planifikuesit e gjuhë në Shqipëri i inkurajuan bashkëpatriotët e tyre jashtë atdheut të pranonin standardin e bazuar në toskërishten.”<sup>17</sup> Rolin e Prishtinës në krijimin e gjuhës së njësuar (the unified language) e kanë vënë në dukje edhe autorë të tjerë të huaj, si Viktor Fridmani, një ndër njohësit më të mirë të situatave gjuhësore në Ballkan<sup>18</sup>.

Ndër autorët shqiptarë jashtë, i pari që ka folur rolin e Konsultës së Prishtinës, është Arshi Pipa, i cili e ka vlerësuar negativisht këtë tubim. Akuzat që ky autor u bën shqiptarëve në ish-Jugosllavi se e “identifikuan veten me stalinizmin shqiptar,” apo se “adoptimi i toskërishtes zyrtare” prej tyre më 1968 “që një dhuratë e dërguar nga zoti për avokatët e gjuhës letrare të njësuar”<sup>19</sup>, janë vlerësuar si shkencërisht të gabuara dhe antikombëtare prej shumicës së autorëve që janë marrë me problemet gjuhës standarde.

Edhe në Shqipërinë e Poshtme, Konsulta e Prishtinës nuk ka mbetur pa u vlerësuar, ndonëse analiza të hollësishme të shkaqeve që çuan në mbledhjen e saj dhe të pasojave që pati, nuk janë bërë. Ndër autorët që kanë folur për të, Xhevat Lloshi është ndalur në rolin e saj në raport me Kongresin e Drejtshkrimit. Në polemikën e tij me Pipën lidhur me rolin e shqiptarëve të ish-Jugosllavisë në standardizimin e shqipes, Lloshi shkruan: “Përpara këtij rreziku të drejtpërdrejtë për fatet e tyre historike, kosovarët u mblodhën në Konsultën e tyre gjuhësore më 1968, kur askush ende në Shqipëri nuk kishte menduar për Kongresin e Drejtshkrimit, që do të bëhej katër vjet më vonë. Ne, gjuhëtarët shqiptarë, e pranojmë me kënaqësi se përkundrazi ka qenë presioni i fakteve në Kosovë një nga faktorët që na çoi te Kongresi i Drejtshkrimit”<sup>20</sup>. Pas tij, M. Çeliku, në kumtesën e mbajtur në Konferencën shkencore “Gjuha Letrare Kombëtare dhe Bota Shqiptare Sot” (1992), shkruan: “Shembulli i Kosovës tregon qartë se parimi kombëtar qëndron mbi qëndrimet politike dhe mbi interesat e ngushtë dhe lokalistë për sa i përket pranimit të gjuhës letrare kombëtare. Qëndrimi miratues i kosovarëve për gjuhën letrare të njësuar mund të quhet faktori më vendimtar në mbylljen e çështjes së

15 R. Ismajli, *Gjuhë standarde dhe histori identitësh*, f. 249.

16 J. Byron, *Language Planning in Albania...*, p. 31.

17 Po aty, p. 35.

18 V. Friedman, *Linguistics, Nationalism, and Literary Languages: A Balkan Perspective*, në "The Real World Linguist: Linguistic Applications in the 1980's", ed. by Victor Raskin and Peter Bjarkman. Norwood, NJ: Ablex. 1986, p. 295-296.

19 A. Pipa, *The politics of language in socialist Albania*, East European Monographs, Boulder, Distributed by Columbia University Press, New York, 1989, p. 5 dhe 214.

20 Xh. Lloshi, *Kultura shqiptare përpara shqetësimesh të reja*, në "Mbështetje për gjuhën letrare", Tiranë, 1997, f. 10 (botuar së pari në revistën "SOT", 1991, nr. 5–6, f. 5–29).

pranimi të saj.”<sup>21</sup> Vërejtja e vetme që i duhet bërë këtij konstatimi, lidhet me pjesën e dytë të tij. Jo “qëndrimi miratues i kosovarëve për gjuhën letrare”, po pranimi prej tyre i toskërishtes zyrtare i bëri shqiptarët me gjuhë standarde.

Edhe në një shkrim polemik të vitit 1995 e kemi titulluar “Konsulta e Prishtinës dhe shqipja standarde”, duke dashur me këtë të theksonim rolin vendimtar të kësaj Konsulte, përkundër B. Becit, i cili gjuhën standarde e shihte si “një dukuri që kishte në themel veprimin administrativ”<sup>22</sup>, dmth. si produkt të ndërhyrjes së shtetit komunist. Atëherë kemi shkruar: “...Konsulta gjuhësore e Prishtinës (1968) shënon pikën kulmore në procesin e gjatë të krijimit të gjuhës standarde shqipe. Ky proces, që nisi me caktimin e toskërishtes si gjuhë zyrtare pas Luftës së Dytë Botërore, miratimin e mori pikërisht nga Konsulta e Prishtinës më 1968 dhe u sanksionua nga Kongresi i Drejtshkrimit, merita e të cilit, sipas nesh, është se siguroi konsensusin (aq i vështirë për t’u arritur mes shqiptarëve!) midis forcave shkencore e lëvrujesve të shqipes në trojet etnike e në diasporë për pranimin e vendimit të kësaj Konsulte.”<sup>23</sup> Këtij pohimi nuk i luajmë asnjë presje edhe sot.

Për të shtjelluar më tej idetë tona lidhur me këtë temë, do të ndalemi në faktorët që shpunë në vendimin e marrë në Prishtinë më 1968, duke u marrë më hollësisht me njërin prej këtyre faktorëve, të trajtuar prej nesh edhe më parë<sup>24</sup>.

A. Xhuvani, përveç konvergjençës së dialekteve, pranonte edhe një rrugë tjetër të mundshme për krijimin e gjuhës letrare kombëtare, atë kur “njeni dialekt, për arsye të ndryshme, do t’i imponohet tjetrit e do të dalë përsipër, po gjithnji edhe ky tue pasë influencën e tjetrit”<sup>25</sup>. Sipas tij, çdo dialekt “e ka fuqinë, i ka cilësitë për t’u bamë gjuhë e përbashkët shkrimi për një popull, por rrethanat shoqërore e bien punën që vetëm një dialekt prej shumë dialekteve të një vendi të dalë sipër të tjerëve e të bahet gjuhë e përbashkët letrare, gjuhë kombëtare”<sup>26</sup>. Por “që të bahet një dialekt gjuhë letrare kombëtare e një populli,— thekson ai,— duhet të shtrihet në gjithë shtresat e tij, të kuptohet e të shkruhet prej gjithë popullit, të bahet malli e prona e tij e padame në çdo shfaqje të jetës së tij”<sup>27</sup>.

Rrethanat e prunë që të realizohej pikërisht mundësia e dytë, të cilën “dekani i gjuhësisë shqiptare” e kishte parashikuar që më 1905, ndonëse nuk mundte kurrsesi t’i parashikonte rrethanat e realizimit të tij. Po cilat ishin rrethanat të cilat bënë që toskërishtja letrare të ngrihej në shkallën e gjuhës standarde dhe a qenë këto rrethana vetëm “shoqërore”, sikundër shprehej Xhuvani?

Në analizat dhe vlerësimet që u janë bërë rrethanave që çuan në vendimin e Konsultës së Prishtinës për heqjen dorë nga varianti i vitit 1963, i miratuar edhe nga organet federative, dhe në pranimin e gjuhës së shtetit amë, janë vënë në pah një varg faktorësh jashtëgjuhësorë. Një palë autorë mbivlerësojnë veprimin administrativ, dmth. ndërhyrjen e shtetit. Autorë të tjerë e shohin standardizimin si pasojë të atdhetarizmit të intelektualëve kosovarë, duke e vlerësuar aktin e tyre si një veprim të lartë patriotik.

Xh. Bajroni, e cila në kreun e pestë të monografisë së saj për standardizimin e shqipes i jep një peshë jo të vogël faktorit politik<sup>28</sup>, më pas duket se e ka modifikuar mendimin e mëparshëm: “Iniciativa për këtë ndryshim,— shkruan ajo në artikullin e saj të vitit 1979,— erdhi

---

21 M. Çeliku, *Gjuha e sotme letrare shqipe – arritje e rëndësishme kombëtare*, në "Çështje të shqipes standarde", Tiranë, 2006, f. 33.

22 B. Beci, *Gjuha letrare shqipe dhe baza e saj dialektore*, në "Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare", Eurorilindja, Tiranë, 1995, f. 206.

23 R. Memushaj, *Konsulta e Prishtinës e 1968-ës dhe gjuha standarde*, AKS, Tiranë, 26–27 gusht, 1995.

24 R. Memushaj, *Planifikimi gjuhësor si objekt i sociolinguistikës*, Studime albanologjike, 1996, Nr. 1, f. 59–84; shih edhe: *Planifikimi si element i strategjisë kombëtare*, STUDIME 4, 1997, Akademia e Shkencave e Kosovës, Prishtinë, 1998, f. 283–300.

25 A. Xhuvani, *Vështrim i shkurtër historik mbi gjuhën shqipe*, Vepra, II, f. 394.

26 Po ai, *Rreth gjuhës letrare kombëtare dhe rreth ortografisë*, Vepra, I, f. 13.

27 Po aty, f. 15.

28 J. Byron, *Selection among Alternates in Language Standardization: The Case of Albanian*, Mouton. The Hague. Paris, 1976, chapter V.

nga bashkësia shqiptare e Jugosllavisë. Edhe pse planifikuesit në Tiranë e pranuan këtë vendim, nuk ka të dhëna që të sugjerojnë se ata i kishin inkurajuar bashkatdhetarët e tyre jashtë atdheut për të përvetësuar standardin e bazuar në toskërishten. Siç u tregua më sipër, në zhvillimin e shqipes standarde planifikuesit e gjuhës nuk shikonin përtej kufijve të tyre shtetërorë”. Duke shqyrtuar rrethanat në të cilat u arrit në vendimin e Konsultës për të pranuar gjuhën zyrtare të trungut amë, autorja në fjalë arrin në përfundimin se shkak ishte “më fort social sesa gjuhësor”<sup>29</sup>. Me shkak “social” ne kuptojmë që vendimi nuk u mor nga politika dhe as u nxit prej saj, po u shkaktua nga pozita shoqërore e shqiptarëve në Jugosllavinë e asaj kohe.

Me përjashtim të A. Xhuvanit, i cili është përpjekur të argumentojë pse toskërishtja i kishte gjasat për t’u vënë në bazën e gjuhës letrare<sup>30</sup>, autorët e tjerë që janë marrë me këtë problem nuk janë ndalur fare ose janë ndalur pak në faktorët *brendagjuhësorë* që shpunë në standardizimin e shqipes. Kostallari, në mbështetje të idesë së tij për gjuhën standarde si një “koine letrare sui generis”, e vinte peshën tek elementet e përbashkëta të dy dialekteve, duke pranuar një përparësi të toskërishtes vetëm në fonetikë<sup>31</sup>. Një përmendje të argumenteve që flasin në të mirë ose kundër vendosjes së variantit letrar tosk në bazë të gjuhës letrare kombëtare dhe që do të vazhdojnë t’i qëndrojnë kohës, e gjejmë te M. Çeliku. Të tilla janë lëvrimi më i madh gjatë periudhës së Rilindjes, karakteri më inovues sidomos në fonetikë dhe homogjeniteti i këtij varianti<sup>32</sup>. Mirëpo, edhe sikur të mos ketë kundërshtime ndaj këtyre argumenteve, prapë është e qartë se pa Konsultën e Prishtinës, standardizimi i shqipes nuk do të kishte ndodhur me atë shpejtësi, sado e bukur dhe e përsosur të ishte toskërishtja. Këtë na e tregon së pari Xh. Bajroni në artikullin e saj të 1979-ës dhe më pas edhe R. Ismajli.

Atëherë ishte thjesht atdhetaria e kosovarëve dhe dashuria e tyre për toskërishten apo pati ndonjë rrethanë tjetër që shpuri në vendimin e Konsultës së Prishtinës? Duke mos u pajtuar me shpjegimet e politizuara të procesit të standardizimit të shqipes, po edhe duke mos u kënaqur me shpjegimet që e vënë theksin në faktorë të tjerë jashtëgjuhësorë, ne kemi mbrojtur idenë se ka një faktor tjetër që shërbeu si shkëndija e cila shkaktoi reaksionin zinxhir që nisi në Prishtinë dhe përfundoi në Tiranë<sup>33</sup>. Ky është faktori që në sociolinguistikë njihet si konflikti mes funksioneve *nacioniste* dhe funksioneve *nacionaliste* të gjuhës.

Për ta kuptuar më mirë këtë faktor, le të sqarojmë më parë përmbajtjen e këtyre termave, që lidhen me emrin e sociolinguistit amerikan Joshua A. Fishman. Sipas këtij gjuhëtari, zhvillimi historik i një bashkësie zë fill me grupin etnik për të kaluar te kombësia dhe pastaj nga kombësia te kombi. Dy fazat e fundit të zhvillimit karakterizohen nga dy lëvizje, të cilat Fishmani i quan nacionalizëm dhe nacionizëm. Nacionalizmi është një lëvizje politiko-kulturore karakteristike për periudhën e kalimit nga kombësia te kombi dhe te shteti kombëtar. Thelbi i nacionalizmit është forcimi i lidhjeve mes njërive krahinore që kanë tradita, histori e gjuhët të përbashkët për të krijuar një njësi të një shkalle më të lartë, kombin. Nacionizmi është një lëvizje e cila ka si qëllim ruajtjen dhe forcimin e njësisë politiko-geografike të krijuar, dmth. integrimin politik brenda kufijve të shtetit<sup>34</sup>.

Si nacionalizmi dhe nacionizmi kanë nevojë për gjuhën dhe i drejtohen asaj, po problemet gjuhësore për secilën prej tyre janë të ndryshme. Pra, gjuha e një bashkësie mund të përmbushë funksione të ndryshme. Një palë funksionesh lidhet me nevojën që ka një shtet i ri për të siguruar funksionimin efektiv të tij. Në këtë rast, shteti ka nevojë për një gjuhë zyrtare dhe si të tillë zgjedh idiomën që mund t’i sigurojë më shpejt komunikimin midis institucioneve qeveritare dhe mes qeverisë e popullit, si dhe të përmbushë nevojat në fushën e

29 J. Byron, *Language Planning in Albania...*, art. i cit., p. 35.

30 A. Xhuvani, *Për themelimin të një gjuhe letrëtare*, Vepra I, f. 5.

31 A. Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, në "Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (20–25 nëntor 1972)", I, Tiranë, 1973, f. 80–84.

32 M. Çeliku, *Gjuha e sotme letrare shqipe – arritje e rëndësishme kombëtare*, art. i cit., f. 31.

33 R. Memushaj, *Planifikimi gjuhësor si objekt i sociolinguistikës...*, f. 59–84.

34 J. A. Fishman, *Nationality-Nationalism and Nation-Nationism*, në J. A. Fishman, Ch. Ferguson, J. Das Gupta (eds.), "Language Problems of Developing Nations", New York, 1968, f. 39–44.

arsimit. Si gjuhë zyrtare mund të zgjidhet një dialekt, si p.sh. gegërishtja para Luftës së Dytë Botërore dhe toskërishtja në periudhën e pasluftës në Shqipërinë politike apo gegërishtja në trojet shqiptare në Jugosllavi deri më 1968; por mund të pranohet edhe një gjuhë koloniale, sikundër ka ndodhur në mjaft vende të Afrikës, Azisë dhe të Amerikës Latine. Kur zgjedhja bëhet duke u nisur nga nevojat pragmatike të qeverisjes së një vendi, dmth. kur i shërben nacionizmit, kemi të bëjmë me funksionin *nacionist* të gjuhës.

Por gjuha mund të përdoret edhe me funksione të tjera, që janë karakteristike për bashkësitë të cilat synojnë krijimin e shtetit kombëtar ose bashkimin me shtetin kombëtar. Këto janë funksionet *nacionaliste* të gjuhës. Sikundër dihet, gjuha është një nga tiparet thelbësore të identitetit kombëtar, mjeti kryesor që i bën folësit e një etnie të ndihen se i përkasin së njëjtës bashkësi kombëtare<sup>35</sup>. Si thelb i kombësisë, ajo kryen "funksione unifikuese dhe separatiste": *unifikuese*, sepse nëpërmjet saj anëtarët e një bashkësie bashkohen në një njësi të vetme, në kombin, dhe identifikohen si të njëjtë me ata që flasin të njëjtën gjuhë; *separatiste*, sepse kontrastojnë dhe ndahen nga ata që nuk flasin të njëjtën gjuhë. Prandaj "nacionalizmi përpiqet në mënyrë të vetëdijshme të krijojë një gjuhë letrare kombëtare moderne, autentike dhe unifikuese, e cila të përdoret atje ku më parë janë përdorur vetëm variante rajonale dhe sociale"<sup>36</sup>.

Në një shkallë të caktuar të zhvillimit të një bashkësie gjuhësore njëri prej këtyre funksioneve ka përparësi, kurse tjetri është latent, i fjetur. Por në rrethana të caktuara historike mund të ndodhë që kërkesat e nacionizmit dhe të nacionalizmit të hyjnë në kontradiktë për sa i përket gjuhës, dmth. të lindë një konflikt midis funksioneve nacioniste dhe funksioneve nacionaliste që përmbush gjuha dhe nga ky konflikt funksion latent del i "fituar"<sup>37</sup>.

Po ta analizojmë në dritën e këtyre dy koncepteve situatën gjuhësore në trojet shqiptare të Federatës dhe në Shqipërinë politike të asaj kohe, do të vërejmë se kishte një ndryshim të dukshëm. Në Shqipërinë politike për nevojat nacioniste, dmth. si gjuhë zyrtare dhe e edukimit, shërbente toskërishtja. Duke qenë se nuk ekzistonte mundësia e lindjes së një konflikti midis funksionit nacionist dhe atij nacionalist, pasi toskët e gegët janë një komb dhe toskërishtja nuk ishte tjetër veçse një variant i gjuhës së përbashkët (ashtu siç nuk lindi para luftës, kur gegërishtja e mesme kryente të njëjtat funksione), problemet e nacionizmit kishin marrë përparësi ndaj nevojave nacionaliste, për zgjidhjen e të cilave në Shqipërinë politike nuk çante njeri kokën, përderisa kufijtë ishin të siguruar.

Në trojet shqiptare të Federatës, gegërishtja kryente një varg funksionesh nacioniste, ashtu si toskërishtja në Shqipërinë politike, me ndryshimin që gegërishtja kishte statusin e gjuhës zyrtare rajonale, duke u përdorur krahas serbo-kroatishtes që ishte gjuha zyrtare e Federatës. Me përpjekjet e ndërmarra në Prishtinë nga viti 1952 e deri më 1964 për njësimin e ortografisë, prestigji i gegërishtes ishte rritur edhe më. Prandaj,– shkruan Xh. Bajroni,– duhet përjashtuar mundësia që udhëheqësit e bashkësisë së shqiptarëve të Jugosllavisë zbatuan normën e dheut amë, sepse gjuhën e tyre standarde (gegërishten–R. M.) e konsideronin si të varfëruar gjuhësisht ose si një sistem të paaftë për të shprehur mendimin modern."<sup>38</sup>

Përpjekjet e planifikuesve gjuhësorë në Prishtinë synonin krijimin e një varianti letrar geg për shqiptarët e Jugosllavisë. Ky synim, i shprehur në të gjitha konsultat e këshillimet për ortografinë deri më 1964, edhe nëse nuk ka qenë nxitur nga Beogradi, padyshim që ka pasur gjithmonë bekimin e tij. Për këtë mjafton të sjellim një njoftim të gazetës "Rilindja" të janarit 1963, ku thuhet se "organet kompetente federative e republikane" "do të marrin në shqyrtim rekomandimet e këtij këshillimi dhe do të aprovojnë format definitive të ortografisë së gjuhës shqipe, që do të përdorin të gjithë shqiptarët e Jugosllavisë"<sup>39</sup>.

35 Po aty, f. 43–44.

36 R. Fasold, *The Sociolinguistics of Society*, Oxford/New York, 1984, f. 6–7.

37 Po aty.

38 J. Byron, *Language Planning in Albania...*, art. i cit., p. 35.

39 Cituar sipas R. Ismajlit, "Në 'gjuh' dhe për 'gjuhë'", f. 169.

Gjer atëherë planifikuesit gjuhësorë nuk e kishin kuptuar, ose nuk kishin guxuar të mendonin, se ku shpinte dhe kujt i shkonte për shtat kjo lëvizje për standardizimin e gegërishtes. Kjo ndodhi më vonë, me mënjanimin e Rankoviçit nga skena politike dhe me liritë që u njohu pakicave qeveria federale. Shtypja e egër kishte dhënë efektin e kundërt mbi popullsinë shqiptare, duke bërë të ngjallej ndjenja kombëtare. Në ngjalljen e kësaj fryme mund të kenë ndikuar, ndoshta, edhe zhvillimet në Shqipërinë politike, prishja e saj me rusët, si dhe zhvillimet pozitive ekonomike e kulturore në vend. Në këto rrethana të reja, intelektualët kosovarë e nuhatën që qarqet shovene serbe donin ta shfrytëzonin diglosinë në rrafshin nacionist për të përjetësuar sundimin e tyre në Kosovë, duke e thëlluar këtë ndarje edhe me emrin “shiptarski ezik” për idiomën e këtushme, përkundër “albanski jezik” për idiomën e Shqipërisë së Poshtme, ashtu siç kishin bërë më parë me maqedonishten.

Pra, kishte lindur konflikti mes nevojave nacioniste (që i përmbushte gegërishtja) dhe nevojave nacionaliste (funksioni identifikues i gjuhës). Pikërisht, duke ndier rrezikun e shkëputjes nga trungu amë me anë të krijimit të një norme të dytë gjuhësore të shqipes, doli në plan të parë funksioni “unifikues dhe separatist” për të cilin flet R. Fasoldi. Popullsia shqiptare e Federatës vendosi “ta pohonte nacionalizmin e saj gjuhësisht duke adoptuar dialektin standard të atdheut” dhe, duke bërë këtë, “ata ripohuan gjithashtu identifikimin e tyre etnik me vendin amë”<sup>40</sup>. Pra, në rastin e trojeve shqiptare të Federatës, nevojat nacionaliste dolën në plan të parë: gjuha zyrtare e Shqipërisë politike u bë gjuhë zyrtare e gjithë kombit, duke marrë përsipër përmbushjen, krahas funksioneve nacioniste, edhe të funksioneve nacionaliste, ndër të cilat më i rëndësishmi është dallimi prej kombësive të tjera dhe bashkimi me trungun mëmë<sup>41</sup>.

Të ndriçuar nga porositë e arkitektëve të kombit tonë se “shumë gjuhë e dialekte sjellin ndarje e mërgimi”<sup>42</sup>, se “njësia e gjuhës është njësia e kombit”<sup>43</sup>, intelektualët kosovarë hodhën hapin që pati pasoja vendimtare për zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës kombëtare, duke e zgjidhur këtë konflikt në të mirë të funksionit nacionalist.

Edhe A. Pipa, megjithëse gjuhën standarde e quan pjellë të diktaturës etj., në një çast kthjellimi e ka shpjeguar veprimin e tyre si një përpjekje për të theksuar kombësinë shqiptare të popullit kosovar dhe për t’iu kundërvënë Federatës Jugosllave, që kundërshtonte t’i jepte Kosovës statusin e Republikës<sup>44</sup>, duke iu afruar kështu së vërtetës. Më vonë, R. Ismajli, në kreun “Dy fjalë në fund” të monografisë “Në gjuhë” dhe “për gjuhë” të botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë më 2005, i afrohet edhe më shumë shpjegimit tonë, duke e përmbyllur librin me fjalët: “Kështu do të zhvillohej procesi i gjatë i standardizimit në rrethanat që bashkësia duhej të luftonte pa ndërprerë për gjuhën, domethënë për atë që ajo perceptonte si shenjën më dalluese kombëtare, pra të identitetit, ndërkohë që pjesa e saj në shtetin shqiptar ishte në gjendje të merrej me gjuhën, pa menduar shumë se atje mund të zhvillohej një luftë në gjuhë, për të cilën në rrethanat e këndejshe nuk kishte shumë mirëkuptim. E qartë, ky nuk ishte aspekti i vetëm i përpjekjeve për standardizimin.”<sup>45</sup>

Nga pikëpamja e tipologjisë së planifikimit gjuhësor, krijimi i gjuhës standarde shqipe përbën një rast më tepër të rrugës së njohur kur si bazë merret njëri nga dialektet. Gjëja e re në këtë proces është se dialekti që u vu në bazë, nuk u zgjodh për arsytet tashmë të njohura në teorinë e planifikimit gjuhësor, por si rrjedhim i daljes në plan të parë i funksioneve nacionaliste të gjuhës, i nevojës për t’u identifikuar me trungun amë dhe për t’u dalluar gjuhësisht nga bashkësitë sllavofone. Nga sa kemi lexuar, ky faktor përbën rastin e vetëm në historinë e standardizimit të gjuhëve dhe një ilustrim *par excellence* të tezës mbi konfliktin mes nacionizmit dhe nacionalizmit në gjuhë.

40 J. Byron, *Language Planning in Albania...*, art. i cit., p. 36.

41 J. L. Byron, *Selection among Alternates...*, vep. cit., f. 136.

42 S. Frashëri, *Letër drejtuar Jeronim de Radës*, Vepra, II, Tiranë, 1988, f. 375.

43 A. Xhuvani, *Për themelim të një gjuhe letrëtare*, art. cit., f. 3.

44 A. Pipa, *The Politics of language...*, vep. cit., f. 4

45 R. Ismajli, “Në gjuhë” dhe “për gjuhë”, në “Gjuhë standarde dhe histori identitetesh”, vep. e cit. f. 250.

Krijimi i një gjuhe standarde është një domosdoshmëri për çdo komb që ka shtetin e vet kombëtar, pra një detyrë që herët e vonë duhet përmbushur. Sikundër dihet, domosdoshmëria realizohet përmes rastësisë dhe rasti fatlumë për shqiptarët e solli që kjo domosdoshmëri të realizohej më herët nga sa mendohej me vendimin e marrë në Prishtinë. Konsulta e Prishtinës ka meritën se përmbushi një detyrë kombëtare dhe prandaj përbën një ngjarje madhore për kombin tonë. Ngjarjet e mëdha u ngjajnë maleve të larta: sa më shumë u largohesh, aq më në pah del madhështia e tyre. Vendime të një rëndësie të tillë shqiptarët i kanë marrë vetëm në momentet kur u është rrezikuar qenia si komb. Lidhja e Prizrenit, Kongresi i Manastirit, Konsulta e Prishtinës dhe Kongresi i Drejtshkrimit, që për ne përbëjnë dy faza të të njëjtit akt, janë ngjarjet më të mëdha në jetën e kombit tonë dhe me efekte në të gjitha trojet etnike, të arritura si rrjedhim i marrëveshjes.

Duke përkujtuar këtë datë dhe duke vlerësuar vendimin historik të konsultës që u mbajt këtu 40 vjet më parë, nderojmë edhe emrin dhe veprën e Ali Hadrit, Fehmi Aganit, Idriz Ajetit dhe të intelektualëve të tjerë të shquar kosovarë të atyre viteve, të cilët shpëtimin nga sllavizimi e gjetën në mbështetjen te trangu amë, ashtu si Abdyl Frashëri 130 vjet më parë e pat kuptuar se, pa Kosovën, nuk mund të përmbushej ëndrra për një Shqipëri autonome. Për të nderuar veprën e të parëve, që me durim, gjak e sakrificë na e ngritën piramidën tonë gjuhësore, duhet të shohim përpara dhe t'u ndalim dorën atyre që me kazmë në dorë duan t'i heqin gurin e kreut kësaj piramide për ta ndarë pastaj më dysh a më trish, duke bërë atë që nuk kanë mundur ta bëjnë pushtuesit gjatë rreth 22 shekujsh pushtimesh të egra. Duhet të njësojmë programet dhe tekstet shkollore, duhet të kërkojmë nga shtetet tona kombëtare të mos hiqen mënjanë, por të miratojnë ligje të rrepta për zbatimin e normave të standardit në veprimtaritë ligjëruese publike dhe për mbrojtjen e shqipes nga trysnia e gjuhëve të huaja.